

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	"Punë oligarkësh", apo jo z.zëvendësministër? - REPORT.AL
ADRESA	https://report.al/pune-oligarkesh-apo-jo-z-zevendesminister/
BURIMI	report.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	15 shtator 2026, 21:30:12 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	15 shtator 2026, 21:22:55 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	f17c4fc7813d929d89a579b7dcc96ff4d620759b758a380114936215b961f849
TEKSTI	4ce1c9491fe1f0ae8dfcfe0a44a3eadecbf5c993bd6127cf356c928aa09e629d
PAMJA	4027742876ff44ae6395e2d5858ff9d6636bd0f42ff6b5159b5835aa06c59a3d

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	ca37ff09555ce1408bb4e2dc18e49950ed02b93cce155da3dcc43dee0ae31869
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	aa0d8cfc8113ea79b7663cf26341788a60de665698217179c4b01fa71930ced4
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërin nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/ca37ff09555ce1408bb4e2dc18e49950ed02b93cce155da3dcc43dee0ae31869>

PAMJA E FAQES


Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Home Aktualitet

“Punë oligarkësh”, apo jo z.zëvendësministër?

by Bota Bota — September 15, 2026 in Aktualitet, Kryesore, Politike

0
SHARES

Share on Facebook

X Share on Twitter

Nga faqja e Instagramit “Punë Oligarkësh” te karriget e shtetit. Rama e mori “kritikun e qeverisë” dhe e vendosi në nyjet ku kalojnë paratë, energjia, Tatimet e Doganat. Sot Yzeiraj mbledh poste e borde, ndërsa po hapen dosjet e rolit të tij në Dogana dhe lidhjeve me interesa të fuqishme biznesi. Sipas logjikës së Ramës; zëvendësministri i bie t’i ketë vënë gjobë dhe kryeministri e paska paguar...

Endrit Yzeiraj sulmonte amnistinë fiskale dhe qeverinë nga faqja e Instagramit “Punë Oligarkësh”. Rama e mori në qeveri dhe sot ish-kritiku është zëvendësministër i Financave, kryetar i Këshillit Mbikëqyrës i OST-së dhe i ulur në disa borde shtetërore që i shtojnë pagesa mbi rrogën. Në dosjen e brendshme të redaksisë po hetohen edhe dy pista të tjera që lidhen me interesat izraelite të afuara me qeverinë Rama dhe roli i tij në Dogana, ku po verifikohen indicie për favore e afëra të dyshuara me disa kompani VIP.

Endrit Yzeiraj kishte një emër të goditur për faqen me të cilën sulmonte qeverinë: “Punë Oligarkësh”. Sot emri tingëllon si një ironi therëse, sepse njeriu që dikur merrej me punët e oligarkëve nga jashtë është futur në zemër të mekanizmit që administrojnë disa nga punët më të mëdha ekonomike të shtetit shqiptar. Si zëvendësministër i Financave, drejton Këshillin Mbikëqyrës të OST-së, është në strukturat drejtuese të Albcontrol-it, Postës Shqiptare dhe Agjencisë së Sigurimit të Depozitave. Një rrogë nga ministria dhe një varg pagesash të tjera nga karriget që shteti i ka dhënë. “Punë oligarkësh”, vërtet.

Katër vite më parë Yzeiraj i “Punë oligarkësh” ishte ndër kritikët e fortë të amnistisë fiskale të Edi Ramës. Fliste për rrezikun e legalizimit të parave të korrupsionit, për pasuritë pa burim dhe për njerëzit pranë politikës që mund të përfitonin nga skema.

Më 8 mars 2023, Rama e mori brenda. Yzeiraj u emërua zëvendësministër i Financave dhe Ekonomisë dhe nisi një ngjitje që nuk u ndal më. Kritiku i sistemit fiskal u bë pjesë e drejtimit të tij, ndërsa njeriu i “Punë Oligarkësh” nisi të mblidhte njëra pas tjetrës karriget e shtetit dhe t’i shërbente pikërisht oligarkëve.

Brenda pak vitesh Rama e lëvizi nga Financat te Ekonomia, më pas te diplomacia ekonomike dhe sërisht te Financat. Në çdo ndalesë, pesha e Yzeirajt u rrit. Sot qeveria i ka besuar edhe kapitujt e negociatave me Bashkimin Europian që lidhen me Tatimet dhe Doganat, dy nga portat kryesore ku biznesi i madh përplasat çdo ditë me shtetin. Në mars 2026 ai përfaqësonte Ministrinë e Financave në projektin e “Dritares së Vetme Kombëtare për Doganat”, përkrah drejtorit të përgjithshëm të Doganave dhe Bankës Botërore, ndërsa në korrik diskutonte me investitorët e huaj ndryshimet që do të prekin tatimet, akcizat dhe Kapitullin 29 për Bashkimin Doganor.

Pikërisht te Doganat po hapet një tjetër dosje që mund ta bëjë historinë e Yzeirajt shumë më të rëndë se ajo e borderove. Sipas burimeve, po hetohet roli i mjeshtrit të “Punë Oligarkësh” në disa marrëdhënie të dyshuara klienteliste dhe favorizuese me kompani “oligarkësh”, të cilat preken drejtpërdrejt nga procedurat doganore, detyrimet, akcizat dhe trajtimi fiskal.

TË FUNDIT

“Punë oligarkësh”, apo jo z.zëvendësministër?

SEPTEMBER 15, 2026

Substancë para plazmaferesës? Misteri i vdekjes së këngëtarit grek Giorgos Mazonakis, çfarë dyshojnë hetuesit

SEPTEMBER 15, 2026

Koncesionet në shëndetësi/ A janë paracaktuar tenderat 18 mln € për Vilma Nushin?!

SEPTEMBER 15, 2026

“Ish-krerët e UÇK-së meritojnë pafajësinë”, një ditë para vendimit, Berisha: Sytë e shqiptarëve drejt Hagës

SEPTEMBER 15, 2026

Video/ Pas Ballukut, edhe Balla përballet me protestuesit: O hajdut, o hajdut

SEPTEMBER 15, 2026

VIDEO/ Shembet vinçi në Miami, operatori shpëton në momentin e fundit, katër të plagosur

SEPTEMBER 15, 2026

Aksidenti në Shkodër/ Autori i dehur i përplasjes dhe viktima ndëshkohen njësoj

SEPTEMBER 15, 2026

“Rama e çoi Veliajn në burg”/ Hoxha: Ai është përgjegjësi kryesor për drejtësinë që kemi sot

SEPTEMBER 15, 2026

Rama përballë drejtësisë që reformoi

SEPTEMBER 15, 2026

Sytë nga Haga/ Pak orë para vendimit për ish-krerët e UÇK-së, në Prishtinë ndizet “Flakët e Lirisë”

SEPTEMBER 15, 2026

Ndërkohë lista e borderove është zgjeruar. Yzeiraj është sot kryetar i Këshillit Mbikëqyrës të OST-së, ku këshilli që ai drejton emëron administratorin dhe mbikëqyr politikat tregtare të kompanisë që kontrollojnë transmetimin e energjisë elektrike në Shqipëri. Është edhe në Këshillin Drejtues të Albcontrol-it, figuron në Këshillin Mbikëqyrës të Postës Shqiptare dhe është anëtar i Këshillit Drejtues të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave. Raporti i pajtueshmërisë së OST-së dokumenton edhe emërimin e tij në Këshillin Mbikëqyrës më 25 qershor 2024.

Pra Endrit Yzeiraj nuk merr vetëm pagën e zëvendësministrit. Ai është futur në një sistem pagesash që nis në Ministrinë e Financave dhe vazhdon në bordet e ndërmarrjeve dhe institucioneve publike. Vetëm nga paga e zëvendësministrit dhe dy shpërblimet që mund të llogariten drejtpërdrejt nga skema ligjore e OST-së dhe Postës Shqiptare, shuma shkon rreth 396 mijë lekë bruto në muaj, afro 4 mijë euro, pa futur ende pagesat nga Albcontrol-i dhe Agjencia e Sigurimit të Depozitave. Pa futur as aferat e korrupsionit sistematik nga ana e tij në institucionet që ka mbikëqyrur dhe drejtuar.

Rama nuk e ka trajtuar Yzeirajn si një zëvendësministër të zakonshëm. E ka lëvizur nëpër ministri dhe paralelisht e ka vendosur në nyje ku kalojnë energjia, paratë, aviacioni, sistemi financiar, tatimet dhe doganat. Kthesa e tij nuk është vetëm politike. Në vitin 2022 kritikonte politikën fiskale të qeverisë; në vitin 2025, tashmë nga karrigia e zëvendësministrit, doli në mbrojtje të "paqes fiskale" të qeverisë dhe mekanizmave të saj. Në nëntor 2025 e prezantonte publikisht paketën si një instrument formalizimi, me falje dhe reduktime detyrimesh për bizneset sipas periudhës së krijimit të borxhit.

Sipas informacioneve që disponon Pamfleti, Yzeiraj po hetohet edhe për rolin dhe kontaktet e tij në dosjet që lidhen me biznesmenët dhe interesat izraelite të afëruara me vitet e fundit me qeverinë Rama.

çfarë ka kaluar në ministritë ku Yzeiraj ka shërbyer, çfarë projektesh ka prekur diplomacia ekonomike gjatë mandatit të tij?

çfarë vendimesh kanë kaluar në OST dhe cilat kompani apo interesa kanë trokitur në institucionet ku ai ka pasur rol vendimmarrës?

Nëse "Punë Oligarkësh" ishte diagnoza që Yzeiraj i bënte dikur pushtetit, sot pyetja është shumë më therëse: sa prej punëve të oligarkëve kalojnë tashmë nga zyrat, doganat dhe bordet ku paguhet Endrit Yzeiraj? **/Pamfleti**

Tags: Edi Rama, Endrit Yzeira, Oligark, Qeveria

Previous Post

Substancë para plazmaferezës? Misteri i vdekjes së këngëtarit grek Giorgos Mazonakis, çfarë dyshojnë hetuesit



Bota Bota

report.al

REPORT.AL

Portali report.al është një media online e pavarur që sjell lajme, analiza dhe informacione të sakta në kohë reale. Me fokus tek transparencia dhe vërtetësia, portali synon t'u ofrojë lexuesve shqiptarë një burim të besueshëm lajmesh nga politika, ekonomia, shoqëria dhe ngjarjet ndërkombëtare.

RUBRIKAT

Aktualitet
OP-ED
Politike
Rajon
Showbiz
Sociale
Shëndet
Sport

MË TË KLIKUARAT

E rëndë, elektrikisti që humbi jetën gjatë punës në Belsh nuk kishte asnjë mjet mbrojtës

01

0 SHARES



Parandalohet ngjarja e rëndë në Rogozhinë, arrestohet i riu që kanosi me kallashnikov 35-vjeçarin

0 SHARES



Identifikohet shqiptari i vrarë në Itali/ E lidhën
dhe e ekzekutuan në makinë, automjetin më pas
e hodhën në lumë

0 SHARES

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.